

GREEN ALBANIA



Të Gjelbrit

Prill 2021

Të Gjelbrit: E gjithë Vjosa të shpallet park Kombëtar



Të Gjelbrit

Rr.Bulevardi Bajram Curri, Pall 31, Shk 1, Ap 4, Tirane, Albania

E-mail: pgj.office@gmail.com

[facebook.com/PartiaeGjelber](https://www.facebook.com/PartiaeGjelber)

[@partiaeGjelber](https://www.instagram.com/partiaeGjelber)

[youtube.com/user/PartiaeGjelber](https://www.youtube.com/user/PartiaeGjelber)

www.pgj.al

Partia e Gjelbër i bën thirrje qeverisë

“Lumi Vjosa të shpallet Park Kombëtar”!

Partia e Gjelbër e Shqipërisë mbështet fuqishëm nismën e organizatave mjedisore për të shpëtuar lumin Vjosa nga hidrocentralet dhe i kërkon qeverisë të shpallë Vjosën ‘Park Kombëtar’.

Vjosa është lumi që lidh Shqipërinë me Europën, është pasuri dhe trashëgimi jo vetëm kombëtare por edhe Europiane. Të Gjelbrit Europian (European Green Party) dhe Grupi i Gjelbër Parlamentar Europian

mbështesin kauzën e Vjosës. Mbrojtja e Vjosës sot nuk është vetëm një obligim i qytetarëve shqiptar por edhe atyre Europian, për të mbrojtur lumin e fundit të egër në Europë.

Parlamenti Europian, në Rezolutën për Raportin e Zgjerimit për Shqipërinë, të miratuar disa ditë më parë në Bruksel, këshillon qeverinë shqiptare të marrë në konsideratë krijimin e Parkut Kombëtar të Vjosës dhe i kërkon të heqë dorë nga planet për

ndërtimin e hidrocentraleve të reja përgjatë lumit Vjosa dhe degëve të saj, pasi këto projekte do të dëmtonin një nga ekosistemet lumore të paprekur pothuaj natyror të fundit në Evropë.

Partia e Gjelbër i bën thirrje qeverisë që Lumi Vjosa të shpallet Park Kombëtar!

Ky është momenti kur qeveria duhet të reagojë dhe të dëgjojë zërin ambientalist, atë të shoqërisë civile si dhe



qytetarëve që luftojnë për të mbrojtur kauzat mjedisore.

Angazhimi i Qeverisë për t’iu përgjigjur me pozitivitet kësaj nisme është një sinjal i rëndësishëm i një politikëbërje miqësore me mjedisin e cila do të mbrojë të gjitha ato pasuri natyrore fatmirësisht të pa dëmtuara ende.

PARTIA E GJELBËR I BËN THIRRJE QEVERISË QË LUMI VJOSA TË SHPALLET PARK KOMBËTAR!



Në trashëguam një Shqipëri të pasur me burime natyrore, me ajër dhe ujë të pastër dhe mjedis të gjelbërruar, ndërkohë po i lëmë brezave të ardhshëm një vend të pa sigurtë, me burime natyrore të shkatërruara dhe mjedis të ndotur.

Është koha që politika t’i kthejë sytë nga mjedisi dhe burimet natyrore sa nuk është tepër vonë.



TË JESH NJË KËSHILLTAR I RI I GJELBËR DHE TË BËSH QË ZËRIJT TË DËGJOHET!

Të Rinjtë e Gjelbër Anglez dhe Të Rinjtë e Gjelbër Shqiptar zhvilluan një takim të përbashkët në platformën Zoom, me temë: Të jesh një Këshilltar i Ri i Gjelbër dhe të bësh që zëri yt të dëgjohe! Në këtë takim morën



pjesë strukturat drejtuese të Të rinjve të Gjelbër dhe këshilltarët e rinj. Nga të Të Rinjtë e Gjelbër Anglez morën pjesë Këshilltarja e re, Amy Heley e zgjedhur si Këshilltare vendore në Brighton & Hove në maj të vitit 2019. Ajo është këshilltarja më e re e qytetit dhe si Kryetare e Komisionit për Mjedisin, Transportin dhe Qëndrueshmërinë, që përqendrohet në transportin e qëndrueshëm, cilësinë e ajrit dhe neutralitetin e karbonit.

Amy solli në këtë takim përvojën dhe sfidat e saj si një këshilltare e re. Gjithashtu ndau me të pranishmit edhe eksperiencën mbi punën që bëhet me implementimin e politikave të gjebra në Këshill, mbi lobimet apo kualicionet e nevojshme.

Rosie Raële si Bashkëkryetare e 'Young Greens' të Anglisë dhe Uellsit, solli përvojën e saj gjatë fushatave elektorale dhe

organizimit të lëvizjeve apo protestave në mbështetje të kauzave të gjelbra. Përfshirja e të rinjve në politikë dhe në listat e kandidatëve ishte një nga sfidat më të mëdha të të rinjve të gjelbër. Alice Hubbard dhe Sarah Sharp ndanë me Të Rinjtë e Gjelbër Shqiptar përvojat e tyre në marrëdhënien ndërkombëtare dhe fuqizimin e rrjeteve rinore të gjelbra. Sarah punon fort me hartimin e politikave që ndikojnë te të rinjtë. Alice është përfshirë në lëvizjen ndërkombëtare të gjelbër për klimën gjatë 5 viteve të fundit, ku ka luajtur rol si Sekretare Globale e të Rinjve të Gjelbër dhe Koordinatore Ndërkombëtare e Partisë së Gjelbër të Anglisë dhe Uellsit. Ndërsa, Të Rinjtë e Gjelbër Shqiptar i njohën kolegët e tyre Anglez me sfidat e tyre, punën që bëhet me të rinjtë, aktivitetet dhe angazhimet e tyre elektorale. Zëri i tyre i gjelbër sot dëgjohe në 15

këshilla bashkiak. Edhe pse të përfaqësuar në këshillat vendor, Të Rinjtë e Gjelbër synojnë rritjen e numrit të këshilltarëve për të pasur një ndikim sa më të madh në vendimarrje dhe jetën në komunitet.

Të Rinjtë e Gjelbër Shqiptar ndanë me kolegët e tyre politikë momente nga angazhimet e tyre të marra për një sërë aksionesh konkrete sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese kundër ndotjes, shkatërrimit të mjedisit dhe ndryshimit klimatike. Ndër të tjera shprehën aspiratën e tyre të përthyer tashmë në objektiv, atë të shndërrimit të organizatës në një forcë potenciale përfaqësuese të politikave të gjelbra në Shqipëri.

Ky takim ishte pjesë e një programi afatgjatë bashkëpunimi midis dy organizatave të gjelbra rinore.

Të Rinjtë e Gjelbër Shqiptar zhvilluan një takim të përbashkët në platformën Zoom, me Eurodeputetin e Gjelbër Gjerman, Z. Niklas Nienass.

Disa nga çështjet që u diskutuan në këtë takim ishin:

- Përshtatja me realitetin e ri në kohën e pandemisë;
- Strategjia e BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe Shqipërinë;
- Ndryshimi i Klimës dhe Sfidat Mjedisore;

Eurodeputeti Niklas, ndau me të Të Rinjtë e Gjelbër mendimet e tij dhe opinionin e Të Gjelbërve Europian për këtë çështje. Ai foli për mbështetjen e vazhdueshme që Të Gjelbërit Europian i japin Shqipërisë dhe Ballkanit perëndimor për integrimin e shpejtë në BE.

Një vëmendje të veçantë gjatë fjalës së tij, Eurodeputeti i kushtoi sfidës mjedisore dhe ndryshimit të klimës. Ai foli për politikën mjedisore që priten të miratohen dhe implementohen nga Bashkimi Evropian si dhe përkushtimin e të rinjve në çështjen e klimës.


Angazhimi i të rinjve në sfidat e mjedisit dhe të klimës – tha Eurodeputeti, tregon se sa i rëndësishëm është zhvillimi i politikave të gjelbra për ta. Ata sot e shohin veten pjesë të kësaj politike vendimarrëse madje kontribuojnë në instancat më të larta vendimarrëse siç është Parlamenti Europian.

Të rinjtë e Gjelbër nga ana e tyre e njohën Eurodeputetin me veprimtarinë e Forumit Rinor, aktivitetet e shumta që ata kanë zhvilluar si dhe angazhimet që kanë marrë në drejtim të mbrojtjes së mjedisit dhe klimës.

Nisma "Fridays for Future" po mbështetet nga shumë të rinj edhe në Shqipëri. Me anë të kësaj lëvizjeje ne, si të rinj, synojmë të ndërgjegjësojmë politikbërjen për të mbrojtur mjedisin dhe klimën – tha drejtuesja e Forumit Rinor. "Koha nuk pret, duhet të reagojmë sa më shpejt që nesër të mos jetë vonë!"

Të Rinjtë e Gjelbër shqiptar kanë zërin e tyre në politikat vendimarrëse lokale në 15 Bashki. Ato po punojnë që ky zë të fuqizohet më shumë jo vetëm duke rritur ndikimin e tyre në komunitetet lokale por dhe në politikën kombëtare.

Të Rinjtë e Gjelbër shqiptar synojnë të kenë zërin e tyre në Parlamentin e Shqipërisë, pse jo në një të ardhme të afërt edhe në Parlamentin Europian.



RRJETI I GRAVE TË GJELBRA

Rrjeti i Grave të Partisë së Gjelbër të Anglisë dhe Uellsit zhvilloi një takim nëpërmjet platformës ZOOM, me Gratë e Gjelbra Shqiptare. Ky takim u zhvillua në kuadër të programit të bashkëpunimit midis dy partive të gjelbra. Synimi kryesor i këtij takimi ishte krijimi i rrjetit të Grave të Gjelbra në Shqipëri dhe hartimi i një platforme të përbashkët ndërvëprimi mes dy partive politike.

Pjesë e këtij takimi ishin dhe këshilltaret e gjelbra të dy Partive të cilat sollën sfidat e tyre dhe punën që bëjnë për të rritur më shumë rolin e gruas dhe influencën e saj në këshill, bashki dhe në komunitet. Gratë e Gjelbra Shqiptare kanë 11 përfaqësuese në këshillat bashkiak.

Natalie McVey, drejtuesja e rrjetit të grave të gjelbra të Anglisë dhe Uellsit, solli përvojën personale si kandidatja e parë e Partisë së saj në Zgjedhjet e Përgjithshme përballë elektoratit në distriktin ku jeton. Ajo u rizgjodh si Këshilltare e Distriktit në vitin 2019 dhe tashmë është pjesë e një Aleance Demokratike që drejton Këshillin. Unë jam Drejtuesja e Portofolit për Strehimin dhe Shëndetësinë – tha McVey, një portofol i gjerë që mbulon të pastrehët, shëndetin dhe mirëqenien fizike dhe mendore, si edhe Artet. Ajo punon për arritjen e barazisë, mbrojtjen e mjedisit natyror dhe luftën kundër mizorisë ndaj kfishëve.



Marjana Gjini, këshilltarja e Partisë së Gjelbër shqiptare, ndau me të pranishmit eksperincën e saj, vështirësitë, sfidat dhe rolin e grave këshilltare për rritjen e influencës në komunitet. Duke u udhëhequr nga Të Gjelbërit European, që kanë qenë pionierë të përfaqësimit të barabartë të sekseve në zgjedhje, ne si Të Gjelbër Shqiptar kemi aplikuar sistematikisht barazinë dhe i'a kemi dalë të feminizojmë instancat tona vendimarrëse. Këtë e tregon më së miri dhe lidershipi i Partisë së Gjelbër të Shqipërisë si e vetmja parti që drejtohet nga dy bashkëkryetar në respekt të barazisë gjinore. Ne do të vazhdojmë të ruajmë këtë traditë të mirë duke i dhënë prioritet faktit që listat tona elektorale të udhëhiqen nga një grua – tha Gjini.

Dy ishin çështjet kryesore të këtij aktiviteti :

- Rëndësia e rrjeteve të grave të gjelbra;
- Përfitimet që kanë gratë nga pjesëmarrja në to;

Drejtimeset dhe këshilltaret e Partisë së Gjelbër të Anglisë dhe Uellsit sollën përvojën e tyre dhe punën që bëjnë për përbalimin e vështirësive, pasi nuk është e lehtë të tejkalosh mentalitetin maskulin edhe në vende si Anglia – thanë ato. Roli i rrjetit të grave të gjelbra i ka dhënë një hov më të madh arritjes së synimit për ta vënë gruan në qendër të vëmendjes dhe për t'i krijuar asaj të gjitha hapsirat dhe mundësitë për t'u integruar, si brenda organizatës ashtu dhe jashtë saj.

Rrjeti është një arritje e madhe në fuqizimin e grave të gjelbra, rritjes së rolit të tyre dhe ndikimit që ato kanë në çuarjen para të politikave të gjelbra dhe përmirësimin e jetës në komunitet. Krijimi i rrjetit të grave të gjelbra në Shqipëri do të jetë një risi që do të forcojë më shumë rolin e gruas si dhe do të rrisë peshën e saj jo vetëm brenda Partisë së Gjelbër por dhe në komunitet.

Ky takim ishte një hap përpara në ngritjen e Rrjetit të Grave të Gjelbra në Shqipëri i cili do të ketë ndikim në përpjekjet që bëjnë gratë për të zënë vendin që meritojnë në politikë dhe shoqëri.

PLANI YNË I ENERGJISË SË PASTËR

Planin ynë i Energjisë së Pastër është një propozim i yni transformues për t'i dhënë fund përdorimit të lëndëve djegëse fosile duke patur një ndikim pozitiv ndaj nryshimit të klimës. Kjo do të ndihmojë për të siguruar brezat e ardhshëm të trashëgojnë një vend ku nuk i duhet të luftojnë për të mbijetuar, por të gëzojnë dhe jetojnë në mirëqënie.

Modeli i zhvillimit i krijuar mbi përdorimin gjithmonë në rritje të rezervave energjetike, është një ekonomi e uljes së një kapitali natyror, të brezave të ardhshëm.

Ne propozojmë energjisë së pastër si një objektivë ambicioze për ta realizuar këtë transformim për të prodhuar energji nga burimet e rinovueshme

- Të Gjelbërit janë për një politike moderne, duke zhvilluar me prioritet energjitë e rinovueshme, si dhe në të njëjtën kohë ushtrimin e kontrollit për ekonomizimin e energjisë. Efiçencën Energjetike
- Elektriciteti me origjinë nga era (eolike) dhe elektriciteti me origjinë diellore (fotovoltaike) duhet të jenë energjitë e së ardhmes.
- Për cdo burim tjetër energjie të rinovueshme miqësor me mjedisin.



- Ne duhet të stimulojmë vendosjen e paneleve diellore në shtëpitë e qytetarëve dhe objektet publike dhe private.
- Ne do të prezantojmë grante për të reduktuar çmimin e instalimit të paneleve në shtëpitë private, dhe do të ofrojmë grante dhe kredi me interes të ulët për bizneset për të kaluar në energji të rinovueshme.
- Për ndërtimin e banesave te reja që mundësojnë projekte të ekspozuara ndaj dritës dhe një pjesë e mirë e ngrohjes se tyre dhe e ujit duhet të sigurohen direkt nga dielli.
- Ne do të krijojmë një Fond të Energjisë së Pastër të cilin komunitetet mund ta marrin për projektet lokale të energjisë së rinovueshme.

Shqipëria ka një pozicion të favorshëm gjeografik që krijon shanset për shfrytëzimin e energjisë diellore. Shanse të tilla janë intensiteti i lartë i rrezatimit diellor, kohëzgjatja e këtij rrezatimi, temperatura dhe lagështia e ajrit, etj. Klima mesdhetare, me një dimër të butë dhe të lagët dhe verë të nxehtë dhe të thatë përcaktojnë një potencial energjetik të madh për shfrytëzimin e energjisë diellore. Energjia diellore është një burim energjie mjaft premtues për të ardhmen dhe përdorimi i saj është potencial, pasi është një burim natyror energjie i pashtershëm. Era garanton energji pa dëmtuar mjedisin dhe me një kosto të pranueshme. Kjo formë energjie është e leverdisshme si nga ana ekonomike ashtu edhe mjedisore. Kjo përbën arsyen që një pjesë më e madhe e energjisë së krijuar nga era të përfshihet në strukturën kombëtare të energjisë. Rezervat e erës të Shqipërisë janë të mëdha.

ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË SHTATOR, KJO ËSHTË GRUAJA QË MUND PASOJË MERKEL DHE TË JETË KANCELARJA E RE E GJERMANISË



Për herë të parë në historinë 40-vjeçare të Partisë së Gjelbër, ambientalistët gjermanë kanë njoftuar një kandidatë që garon për kancelare. Bëhet fjalë për Annalena Baerbock, e cila ka mundësinë që të pasojë Angela Merkel, nëse forca e saj politike arrin rezultat të mirë në zgjedhjet e përgjithshme të shtatorit. Barazia historike është një rol qendror që të gjelbrit do të luajnë për të fituar besimin e qytetarëve. "Sot është fillimi i një kapitulli të ri në partinë tonë dhe nëse ne ecim mirë, do të jetë edhe për vendin tonë. Kemi një ide të qartë për kancelarinë

gjermane. Me kandidimin tim dëshiroj të bëj një ofertë për të gjithë shoqërinë si një ftesë për të udhëhequr shtetin tonë të pasur, fuqishëm dhe divers drejt një të ardhmeje të mirë. Kjo kërkon ndryshime dhe ne mund t'i bëjmë ato". Annalena Baerbock, kandidatë për kancelare.

Annalena Baerbock ka mundësinë që të pasojë Angela Merkel, nëse forca e saj politike arrin rezultat të mirë në zgjedhjet e përgjithshme të shtatorit. 40-vjeçarja Baerbock ka shumë gjasa që të jetë e vetmja grua në garë. Dikur, të gjelbrit janë parë si një grupim hipish me mjekra dhe sandale, tani kjo parti ka shanse

reale që të jenë pjesë e qeverisë së ardhshme të Gjermanisë.

Me konservatorët në kaos mes grindjeve për kandidatin e tyre, ambientalistët mund të jenë forcë e parë në koalicion. Kjo do të mundësonte që Annalena Baerbock të jetë kancelarja e ardhshme e vendit. Kandidatja ka lindur në 1980-ën, po të njëjtin vit kur u themelua dhe Partia e Gjelbër. Prindërit e morën atë në demonstratat anti-bërthamore dhe e përshkruan fëmijërinë e saj si një miks mes protestave të dhunshme dhe qetësisë në shtëpi. Ndërkohë, sipas sondazheve, të gjelbërit do të fitojnë 22 përqind të votave, të dytët pas bllokut konservator CDU/CSU të Merkel.